



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 54/14 Prot.

Shkodër, më 06/04/2022

URDHËR

Nr. 236 Datë 06/04/2022

“Mbi marrjen e masave paraprake për shërbimin e pastrimit në plazhin e Velipojës, me qëllim përgatitjen për sezonin turistik 2022”

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 për “ Vetëqeverisjen Vendore“ neni 23 pika 10, bazuar në nenin 21 pika 12 të Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2021 i ndryshuar, “Për menaxhimin e Integruar të mbetjeve, kontratës dypalëshe midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe Operatorit sipërmarrës Leka-2007 me Nr.24867Prot datë 31.12.2021 “ Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër, zona Perëndimore”;

URDHËROJ:

1. Të merren masa nga operatori i ofrimit të shërbimit të pastrimit të zonës perëndimore konkretisht në njësinë Administrative Velipojë zona e plazhit, mbi shërbimin e pastrimit për përgatitjen të sezonit turistik të vitit 2022 dhe përmirësimin e performancës mjedisore të Velipojës gjatë gjithë sezonit turistik;

2. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës të bashkëpunojë me operatorin e ofrimit të shërbimit të pastrimit në zonën e plazhit në sigurimin e fuqisë punëtore për marrje masash në pastrim me qëllim përgatitjen për sezonin turistik 2022, për angazhimin në pastrimin e territorit duke nisur nga hyrja për në Velipojë plazh, bankinat e rrugës nacionale nga mbetje të shumta (shishe, qese etj), pastrimin e brezit të rërës, mirëmbajtës të pikave të grumbullimit etj, në mënyrë të tillë që i gjithë territori të ofrojë kushtet më të mira higjienike në pritje të sezonit turistik 2022;

3. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës, të hartojë dokumentacionin përkatës proceduralo-administrativ në bashkëpunim me operatorin sipërmarrës të shërbimit;

4. Për zbatimin e këtij urdhëri, ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës dhe Drejtoria e Financës.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

